

## Vijojnë aktivitetet e “Muajit të Hapur në KLSH” për periudhën 12-16 nëntor 2018

KLSH gjatë periudhës 12-16 nëntor ka vijuar zhvillimin e aktiviteteve të “Muajit të Hapur” të planifikuara në Program për këtë periudhë.

### Departamenti i Auditimit të Performancës zhvilloi aktivitetin “Pse Performancë?”

Në datën 12.11.2018, Drejtoresha e Përgjithshme e KLSH-së, znj. Lindita Lati (Milo) dhe Drejtori i Departamentit të Performancës, z.Rinald Muça, mbajtën leksionin me temë “Pse performancë?” me audituesit e KLSH-së. Ky takim, i cili u realizua në kuadër të Muajit të Transparencës mbledhi auditues nga Departamenti i performancës dhe departamente të tjera të KLSH-së.



Në fjalën e tij, z. Muça theksoi rëndësinë e auditimit të performancës në raport me auditimet e tjera (të përputhshmërisë dhe financiarë), si dhe në lidhje me kontekstin shqiptar. Ai bëri një rezymë të ecurisë së Departamentit nga themelimi i tij në Tetor 2012, deri në ditët e sotme. Në këto vite Departamenti ka njohur rritje të konsiderueshme në sasi dhe cilësi, si në burime njerëzore, ashtu edhe në produktet audituese. Audituesit e performancës kanë ardhur nga background-e të ndryshme arsimore dhe profesionale, duke dhënë kontributin e tyre në auditimin e institucioneve dhe politikave më të rëndësishme dhe më me risk në vend. Drejtori i Performancës e cilësoi këtë lloj auditimi si krijues, sfidues për këdo dhe si një nga arritjet më të mëdha të leadershipit aktual të KLSH-së, pas miratimit të Ligjit të plotë dhe modern nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.



Një fakt i tillë u përmend edhe nga Kryetari i KLSH-së, z. Leskaj, në prezantimin e zhvilluar gjatë vizitës më të fundit në SAI-n kroat, me temë “Kur është hera e fundit që keni bërë diçka për herë të parë?”.

Gjatë diskutimit të saj, znj. Lati përcolli tek audituesit e KLSH-së vlerat e Departamentit dhe të auditimit të performancës, sfidat që e presin dhe mundësitë për përmirësim të mëtejshëm, në përputhje edhe me Planin Strategjik të KLSH-së 2018-2022. Indikatorët e performancës sipas NAO-s britanike dhe monetarizimi i E-ve të cenuara (efektivitet, efizienzë, ekonomikitet) do të jenë dimensionet që duhet të prekin audituesit e performancës për të përmbushur me sukses funksionin e tyre dhe të vetë KLSH-së si gardianë të përdorimit të fondeve publike.

Leksioni u realizua në mënyrë interaktive dhe pati bashkëbisedime dhe komente nga ana e dy drejtuesve të lartë dhe pjesëmarrësve.

### **KLSH dhuron kompjutera për nxënësit e shkollës së mesme në bashkinë Selenicë**

Në datën 13 nëntor, Drejtori i IT dhe Logjistikës, z.Ali Azizaj dhe Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të IT-së, z.Kozma Kondakçiu ishin në Shkollën e mesme të Bashkisë Selenicë.

Zoti Kondakçiu i njohu nxënësit e kësaj shkolle me mënyrën e funksionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe u ndal veçanërisht në rolin që ka në ditët e sotme teknologjia e informacionit.



Pikërisht për t'u ardhur në ndihmë të rinjve të kësaj shkolle në drejtim të përmirësimit dhe të zbatimit në praktikë të teknologjive të reja, KLSH u dhuroi 28 kompjutera nxënësve të kësaj shkolle, me qëllim krijimin e laboratorit të Informatikës.



### **Vizitë e studentëve të Universitetit “Marin Barleti” në KLSH**

Në datën 13 nëntor 2018, pasi ishin informuar përmes web-faqes së institucionit për zhvillimin e “Muajit të Hapur në KLSH”, një grup studentësh të Departamentit të Shkencave Politike të Universitetit “Marin Barleti” vizituan Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Studentët shoqëroheshin nga dy pedagogje të departamentit të tyre, ndërkohë që znj. Irena Islami, Drejtore e Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, ishte mikpritësjja

nga punonjësit e KLSH-së. Takimi u organizua në Muzeun e KLSH-së dhe duke qenë se si studentë të shkencave politike, ata ishin mjaftueshëm të njohur me KLSH-në si një organ i pavarur i sanksionuar në Kushtetutë, diskutimi ishte shumë i thjeshtë dhe interaktiv. Znj. Islami, i bëri një pasqyrë të shkurtër të detyrave dhe të drejtave të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ashtu siç parashikohen edhe në Ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, para se të bënte edhe një shpjegim të përmbledhur të strukturës së brendshme të institucionit.



Detaj që i bëri përshtypje studentëve, ishte të qënit e Kontrollit të Lartë të Shtetit, jo vetëm një institucion financiar, ashtu si shumica e pandehnin. Kureshtja e tyre më e madhe lidhej me Departamentin e Auditimit të Performancës dhe auditimet që ky departament kryen. Zonja Islami i bëri një përshkrim të shkurtër të punës së këtij departamenti dhe i adresoi në faqen zyrtare të KLSH-së në internet, në rast se dëshironin të njiheshin më gjerësisht me auditimet e bëra. Disa prej studentëve shprehën interes për të përdorur raportet e auditimeve që do të gjenin edhe në detyrat e tyre të kursit.

Pas përfundimit të bisedës ata u shpërndanë në ambientet e Muzeut të KLSH-së për të vizituar muzeun. Ndërkohë që znj. Fatjona Qurku, Koordinatore e Departamentit të Shkencave Politike pranë Universitetit “Marin Barleti”, shprehu interes dhe për bashkëpunime të tjera në të ardhmen, për të cilat KLSH është gjithmonë e gatshme për t’i pranuar.

### **KLSH merr pjesë në edicionin e XXI<sup>të</sup> të Panairit të Librit**

Në datat 14-18 nëntor 2018, Kontrolli i Lartë i Shtetit mori pjesë në edicionin e XXI<sup>të</sup> të Panairit të Librit, në Tiranë, duke shënuar kështu për të gjashtin vit radhazi një pjesëmarrje dinjitoze, duke u paraqitur me 95 botime përkundrejt 17 botimeve të vitit 2013, kur mori pjesë për herë të parë modestisht në këtë panair. Botimet e KLSH, krahas informimit të opinionit të gjerë publik, i ndihmojnë audituesit publikë për formimin e kapaciteteve të tyre, zbatimin rigoroz të standardeve të INTOSAI-t dhe shkëmbimin e eksperiencave të mira të punës, në bazë të motos së INTOSAI-t “*Nga eksperiencia e përbashkët përfitojnë të gjithë*”.



Në datën 16 nëntor në Pallatin e Kongreseve u organizua promovimi i kolanës së botimeve të KLSH-së. Në këtë aktivitet morën pjesë drejtues e auditues të KLSH-së, Prof. Dr. Skënder Osmani, Prof.Dr.Pajtim Ribaj, Prof.Dr. Sazan Guri, përkthyesi Astrit Beqiraj, ekspertë të jashtëm të KLSH-së dhe përfaqësues të medias.

**Aktivitetin e hapi Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z.Bujar Leskaj**, i cili theksoi se *“mbështetur në Strategjinë e Zhvillimit të institucionit për vitet 2018-2022 dhe në Strategjinë e Komunikimit të KLSH-së 2017-2019, ne jemi mbledhur sot në këtë sallë për të promovuar botimet e KLSH-së në vite dhe veçanërisht ato të vitit 2018. Titujt e botimeve të KLSH-së në këto shtatë vite janë vërtet impresionues, si për lamirshmërinë e temave, thellësinë e argumentit shkencor, të dhënat historike, vlerën e konkluzioneve dhe përsiatjeve, ashtu dhe për sasinë e informacionit që përmbajnë, si për lexuesit e fushës së auditimit dhe të ekonomisë, ashtu edhe për lexuesin e thjeshtë të interesuar për fushën e auditimit”*.



*Njoftimin e plotë për këtë aktivitet e gjeni në linkun [http://www.klsh.org.al/web/KLSH\\_merr\\_pjese\\_ne\\_edicionin\\_e\\_XXIte\\_te\\_Panairit\\_te\\_Librit\\_36\\_30\\_1-1.php](http://www.klsh.org.al/web/KLSH_merr_pjese_ne_edicionin_e_XXIte_te_Panairit_te_Librit_36_30_1-1.php)*

### **KLSH merr pjesë në tryezën e rrumbullakët ndër-institucionale organizuar nga USAID**

Në kuadër të implementimit të projektit “Transparenca në sistemin shëndetësor” financuar nga USAID, në datën 14 nëntor 2018 u organizua në Tiranë një tryezë e rrumbullakët me temë *“Fuqizimi i transparencës institucionale dhe angazhimit qytetar për përmirësimin e cilësisë në sistemin shëndetësor-sfida dhe mundësi bashkëpunimi”*.

Në këtë takim morën pjesë drejtues të tre institucioneve që janë pjesë e këtij projekti : KLSH, ILDKPKI dhe Avokati i Popullit, si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe medias. Gjatë takimit u diskutua rreth angazhimit qytetar në rritjen e transparencës dhe cilësisë në sistemin shëndetësor.

Fjalën e rastit në këtë tryezë e mbajti zj.Mikaela Meredith, Drejtoreshë e USAID për Shqipërinë. Zonja Meredith ritheksoi faktin që projekti ka për qëllim krijimin e një mjedisi më të përgjegjshëm për përdorimin e parave publike duke forcuar institucionet mbikëqyrëse si KLSH, Avokati i Popullit dhe ILDKPKI dhe duke rritur bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe median.



Asistenca teknike që USAID po i ofron KLSH-së konsiston në përmirësimin e auditimeve të performancës në sektorin e shëndetësisë, rritjen e aksesit të qytetareve tek informacioni, futjen e disa zgjidhjeve teknologjike për sistemin e ankesave, përdorimin e të dhënave të hapura dhe treguesve të alarmit-red flags për fusha të prirura për korrupsion, etj.

Më pas e mori fjalën Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj, i cili theksoi që realizimi i kësaj tryeze të rrumbullakët nuk përbën thjesht një aktivitet të radhës, por përfaqëson një moment të rëndësishëm të paraqitjes së instrumenteve që janë projektuar dhe që kanë filluar të aplikohen, me synimin e rritjes së transparencës tek shoqëria civile dhe tek publiku i gjerë, por jo vetëm. Përfitimi nga përdorimi i teknologjisë së informacionit, për të identifikuar transaksionet me risk më të lartë potencial në procedurat e prokurimit publik ndikon në rritjen e efijencës dhe impaktit të aktivitetit auditues të KLSH-së.

*Njoftimin e plotë për këtë aktivitet e gjeni në linkun [http://www.klsh.org.al/web/KLSH\\_merr pjese ne tryezen e rrumbullaket nder institucionale organizuar nga USAID 3624 1-1.php](http://www.klsh.org.al/web/KLSH_merr pjese ne tryezen e rrumbullaket nder institucionale organizuar nga USAID 3624 1-1.php)*

### **KLSH zhvilloi në Tiranë trajnimin me temë “Teknologjia e informacionit - Mbështetje IT në proceset e auditimit dhe softwerët e auditimit”**

Në datat 14-15 Nëntor 2018, në Tiranë, u zhvillua trajnimi IT me temë “Teknologjia e informacionit - Mbështetje IT në proceset e auditimit dhe softëerët e auditimit”.

Ky bashkëpunim udhëhiqet nga misioni i Rrjetit të vendeve candidate dhe vendeve potenciale candidate për në BE, duke synuar kërkimin e zgjidhjeve për problemet e përbashkëta dhe zhvillimin progresiv të punës audituese të SAI-ve të vendeve të këtij rrjeti në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ky trajnim u organizua bazuar në planin e punës të Rrjetit për periudhën 2018-2020, i cili është zhvilluar në bazë të inpueteve të nxitura nga një sondazh i shkurtër i kryer nga SIGMA për të marrë pikëpamjet e rrjetit mbi prioritetin e aktiviteteve.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ishte SAI mikpritës dhe në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga SAI-t e Turqisë, Serbisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Bosnje-Hercegovinës. Fokusi kryesor i trajnimit ishte mbështetja e IT në proceset e auditimit.



Drejtoresha e Përgjithshme znj.Lindita Lati (Milo), në emër të Kryetarit të KLSH, përshëndeti dhe u uroi mirëseardhjen SAI-ve pjesëmarrëse në aktivitet. Në fjalën përshëndetëse znj.Lati theksoi se zhvillimi i Teknologjisë së Informacionit vendosi nevojën për të përmirësuar kapacitetin tonë për të absorbuar teknologjinë e re dhe për të mbështetur qasjen inovative të auditimit IT.

*Njoftimin e plotë për këtë aktivitet e gjeni në linkun [http://www.klsh.org.al/web/KLSH\\_zhvilloi\\_ne\\_Tirane\\_trajnimin\\_me\\_teme\\_Teknologjia\\_e\\_informacionit\\_Mbeshtetje\\_IT\\_ne\\_proceset\\_e\\_auditimit\\_dhe\\_softëeret\\_e\\_auditimit\\_3626\\_1-1.php](http://www.klsh.org.al/web/KLSH_zhvilloi_ne_Tirane_trajnimin_me_teme_Teknologjia_e_informacionit_Mbeshtetje_IT_ne_proceset_e_auditimit_dhe_softëeret_e_auditimit_3626_1-1.php)*

### **Prezantimi nga AIS për Red Flags dhe Open Data**

Në datën 15 nëntor në ambientet e KLSH-së, në kuadër të Projektit “Transparenca në sistemin Shëndetësor” financuar nga USAID dhe në bashkëpunim me Institutin Shqiptar të Shkencës (AIS) u organizua një aktivitet i përbashkët.

Aktiviteti u fokusua në arritjet e dy produkteve të këtij Projekti “Red Flags” dhe “Open Data”.

Prezantimi u bë nga ekspertja e AIS, zj.Viola Civici. Në aktivitet morën pjesë auditues të KLSH-së, përfaqësues të USAID, të AIS dhe përfaqësues të OJF-ve që operojnë në sistemin shëndetësor.





Drejtoresha e përgjithshme, zj.Manjola Naco vlerësoi projektin si shumë të dobishëm për audituesit e KLSH-së.

Zonja Civici gjatë prezantimit të saj theksoi se puna audituese përfshin auditimin dhe vlerësimin e procedurave të prokurimit publik dhe për këtë arsye algoritmi **red flags** ndihmon në analizimin e bazës së të dhënave ku vendosen procedurat e tenderimit dhe realizon klasifikimin automatik në problematikë ose jo. Në këtë mënyrë instrumenti do të ndihmojë audituesit e KLSH-së duke mundësuar indicie në kohë reale mbi procedurat me probabilitet për sjellje të papajtueshme me ligjin.

Instrumenti i zhvilluar në kuadër të projektit “Transparenca në Sistemin Shëndetësor” mundëson filtrim të detajuar të procedurave në bazë të fushave të ndryshme si: Autoriteti Prokurues, Institucion Tenderues, Operator Ekonomik Kontraktues, Vlera/Fondi Limit, Statusi i Tenderit, Lloji i Kontratës Publike, Lloji i Procedurës, Data e Njoftimit të Tenderit, Data e Mbajtjes së Tenderit, etj.

Baza e të dhënave që përdor instrumenti red flags në rastin e Kontrollit të Lartë të Shtetit përfshin procedura tenderimi të fushës së shëndetësisë të shpallura nga data 1 Janar 2016 dhe vazhdon të përditësohet me procedura të reja.



### **Instrumenti për publikimin e raporteve në format Open Data**

Aktualisht vendimet dhe raportet e auditimit të KLSH publikohen në Website-n zyrtar në format pdf. Nëpërmjet instrumentit të open data mundësohet një paraqitje më koncize dhe më e lexueshme e objektivave dhe konkluzioneve të auditimeve për qytetarët apo media-n.

Nga ky instrument, krahas publikimit të raporteve sipas llojit: Performance, Rregullshmërie, Teknologjie Informacioni apo raporte vjetore ato klasifikohen sipas fushave shëndetësi, arsim, financë, etj. Gjithashtu që informacioni të jetë më i detajuar do të vendoset raporti dhe vendimi në formë të aksesueshme nga publiku.

KLSH e mbështet transparencën përmes të dhënave të hapura (open data), e cila arrin t'i përpunojë dhe publikojë këto të dhëna bazuar në teknologjitë më të fundit të informacionit.

Pas prezantimit të zj.Civivi pati shumë pyetje dhe diskutime nga të pranishmit në sallë.